# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-439386**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Allajbeut i ikin 50 milionë eurot e hemodializës, shkarkohet e besuara e tij |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1391276.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 08:56:08 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 13 shtator 2026, 08:50:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 13 shtator 2026, 08:49:00 UTC → 13 shtator 2026, 08:51:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3c22610b054f1f2fd5ae4e4f12914313c1cbec37cfd6242ae5a0f173d16243d9` |
| TEKSTI | `439c9a9ba7fa220bcb8c4db3bd0137704ee1847bdb96e590a04a91f01b95de80` |
| PAMJA | `75939c753b2e91b6e2beb3cc33c3818cc191ca42145b8e00bdc1b43a704b3b22` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `64d6dce1fa6187289291f285cd3d1cc49e35f79c38b9a0bffc6055237539939b` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `10ab5b8f79eea0a6c9439c21099c504de5d405b01d4b1e67f07490a5465dacd2` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/64d6dce1fa6187289291f285cd3d1cc49e35f79c38b9a0bffc6055237539939b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Allajbeut i ikin 50 milionë eurot e hemodializës, shkarkohet e besuara e tij

Shkruar nga: S. H | Publikuar më: 13.09.2026, 10:50

Share Share




Pas denoncimeve të JOQ, tenderi afro 50 milionë euro për hemodializën në pesë spitale rajonale është anuluar, duke i dhënë fund për momentin procedurës që do t'i rikthente në lojë biznesmenit Klodian Allajbeu një kontratë të re shumëvjeçare në shëndetësinë publike. Kompania "Diaverum AB", e vetmja pjesëmarrëse në garë, ishte shpallur fituese me një ofertë prej 4.44 miliardë lekësh, rreth 97% e fondit limit. Procedura kishte ngritur pikëpyetje pikërisht për mungesën e konkurrencës dhe faktin se pas skemës së re të kontraktimit shfaqeshin sërish emra të lidhur me operatorin e mëparshëm të hemodializës.

Anulimi vjen bashkë me një tjetër lëvizje, largimin e Arisa Canes nga drejtimi i OSHIS dhe emërimin e Yllka Shetës në vend të saj. Cane kishte punuar më herët në Spitalin Amerikan, të lidhur me Allajbeun, ndërsa "Diaverum" lidhet me "DiaVita", kompaninë që kishte zbatuar koncesionin e mëparshëm të hemodializës. Kjo përputhje kishte ushqyer dyshimet se, pavarësisht se koncesioni i vjetër po përfundon dhe shërbimi po kthehet nën administrimin e shtetit, paratë publike mund të përfundonin sërish te i njëjti rreth biznesi.

Tashmë, kontrata që po shkonte drejt firmosjes është bllokuar dhe Allajbeu mbetet pa kontratën e re 4-vjeçare prej afro 50 milionë eurosh. Por skandali nuk mbyllet me anulimin. Pyetja kryesore është se si një institucion i sapokrijuar si OSHIS arriti të zhvillojë një procedurë të tillë, me vetëm një ofertues dhe me vlerën e ofertës pothuajse të barabartë me fondin limit, përpara se Ministria e Shëndetësisë të ndërhynte në minutat e fundit. Tani pritet tenderi i ri, ndërsa mbetet për t'u parë nëse këtë herë do të ketë një garë reale apo thjesht një tjetër rrugë për të çuar paratë publike te të njëjtët përfitues.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.